



# VLERËSIMI I RREZIKUT NGA FINANCIMI I TERRORIZMIT PËR ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE

Ky publikim është zhvilluar si pjesë e një projekti për Maqedoninë e Veriut, i menaxhuar nga Qendra Evropiane për Ligjin Jofitimprurës (ECNL). Projekti financohet nga Qendra Ndërkombëtare për të Drejtën Jofitimprurëse (ICNL) përmes Nisma e Hapësirës Qytetare. Ky publikim financohet nga Qeveria e Suedisë. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Qeverisë së Suedisë. Autori mban përgjegjësi të plotë për përmbajtjen e shprehur.



Grupi i punës për aksion financiar (FATF) paraqet mburojë globale nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit (FT). Ky është trup ndërqeveritar që paraqet standarde ndërkombëtare që shtetet të mbrohen prej këtyre aktiviteteve ilegale. Në sistemin për parandalim dhe mbrojtje, përveç institucioneve, është e rëndësishme të marrin pjesë të gjithë aktorët. Organizatat jofitimprurëse (OJF) janë pjesë e rëndësishme e këtij sistemi dhe gjithnjë e më shumë kyçen që të mbrohen nga keqpërdorimet e mundshme.

Një pjesë të standardeve që FATF ua jep shteteve kanë të bëjnë edhe me sektorin OJF. Sipas FATF Rekomandimi 8<sup>1</sup>, çdo shtet duhet të caktojë nëngrup në sektorin OJF i cili mund të keqpërdoret për FT; të vlerësojë sa masat

Në Maqedoninë e Veriut deri më tani nuk është shqiptuar aktgjykim kundër ndonjë OJF për financimin e terrorizmit

<sup>1</sup> Formulimi paraprak i këtij rekomandimi theksonte se OJF janë “veçanërisht të cenueshëm ndaj keqpërdorimit të terrorizmit”. Kjo ishte ndryshuar në vitin 2016 pasi u dëshmuar se në aspektin ndërkombëtar rastet e keqpërdorimit të OJF janë të rralla dhe pasi disa shtete në mënyrë të padrejtë e kanë përdorur formulimin për ta kontrolluar sektorin për arsye të tjera.

ekzistues (politike, ligje, aktivitete) janë përkatëse për mbrojtje; t'i vlerësojë rreziqet reale dhe për to të definojë masa që nuk do ta pengojnë punën legjitime të OJF, ndërsa do të mundësojnë mbrojtje efektive.

Prandaj Drejtoria për Zbulim Financiar (DZF) së bashku me një sërë institucionesh dhe sektorin OJF bëri Vlerësimin e rrezikut të financimit të terrorizmit për OJF në Republikën e Maqedonisë së Veriut (RMV) që Qeveria e ka miratuar. Përmes analizës Vlerësimi mundësoi që të kuptohet se cilat OJF dhe deri në cilën shkallë janë ekspozuar në rrezik nga keqpërdorimet e mundshme për FT, siç janë faktorët e rrezikut dhe se si më tej të zhvillohen masat mbrojtëse.

## CILAT OJF JANË PËRFSHIRË NË KËTË VLERËSIM?

Vlerësimi i përfshiu OJF në RMV që i përmbushin elementet e definimit të OJF dhe FATF2 edhe atë:

- shoqata (rreth 65% të personave juridikë që janë harmonizuar me definimin);
- fondacione;
- Kryqi i Kuq;
- organizata joqeveritare të huaja dhe ndërkombëtare;
- kisha, bashkësi fetare dhe grupe religjioze.

## ÇFARË JANË RREZIQET PËR FT DHE SE SI OJF MUND TË KEQPËRDOREN?

Nuk është përcaktuar dhe as dëshmuar financimi i terrorizmit përmes OJF në Maqedoninë e Veriut. Vlerësimi tregon se për shumicën e OJF rreziku është i ulët dhe për rreth 13% është i ulët deri në mesatar. Kështu, ekziston mundësi OJF veprimtaria e së cilave është e karakterit socio-humanitar, kulturor-arsimor dhe/apo religjioz dhe përfshin ofrimin e shërbimeve të involvohen dhe keqpërdoren për qëllimet e FT në raste kur në mënyrë të kryqëzuar përmbushen edhe disa prej faktorëve vijues të rrezikut:

2 OJF të cilët nuk bien nën definimin e FATF janë: sindikata, shoqata të pronarëve, partive politike, grupe joformale të interesit, nisma qytetare, klube sportive dhe organizata që nuk i shërbejnë interesit më të gjerë publik ose bashkësisë por vetëm anëtarësisë së tyre.

- Udhëheqësia e OJF janë persona eksponentë të ideologjisë fetare radikale;
- OJF janë regjistruar ose janë aktive në rajone të përcaktuara si të rrezikshme për terrorizmin;
- Donacione/ sponsorime të transferuara nga vendet me rrezik të lartë ose vende në të cilat ka konflikte ose luftëra;
- OJF nuk sigurojnë informacione për aktivitetet e tyre dhe transaksionet e kryera financiare në mënyrë në të cilën mund të verifikohet nga institucionet.



## **CILAT JANË MASAT MBROJTËSE QË REKOMANDOHEN?**

---

### **Çfarë mund të bëjë sektori OJF?**

- Të kyçet në nisma për vetërregullim që vendosin standarde për punën e mirë organizative. Me këtë OJF do të kenë mekanizma më të mira organizative për mbrojtje;
- Të bashkëpunojë me institucionet dhe me bankat në krijimin e një sistemi më të mirë për financimin e terrorizmit dhe larjen e parave të bazuara në rreziqe. Përfshirja e OJF në dialog për politika dhe masa të ardhshme të institucioneve dhe bankave do t'u japë informacione për atë se si punon sektori;
- Në kuadër të sektorit OJF të zhvillohet vetëdija për rëndësinë e menaxhimit me rreziqet, të përforcohen kapacitetet dhe në mënyrë të ndërsjellë të shkëmbehen praktika të mira.

## Si mund të mbrohet organizata ime?

- Të informohet, t'i kuptojë dhe identifikojë rreziqet e FT për OJF sektorin dhe për organizatën e saj;
- Të edukohet për atë se si mund t'i zhvillojë mekanizmat e veta për mbrojtje nga keqpërdorimet;
- Ta përforcojë menaxhimin e mirë dhe punën financiare;
- Ta përforcojë transparencën dhe llogaridhënien;
- Ta harmonizojë punën e vet me mekanizmat e vetërregullimit.

## Cilat janë mekanizmat për vetërregullim?

Ekzistojnë më shumë nisma dhe mekanizma të vetërregullimit në sektorin qytetar. "Marka për besim" është sistem vetërregullues i cili vepron sipas standardeve të larta për punën e kryer mirë me çka e përforcon besimin në sektor. Kriteret për Markën e Mirëbesimit i përfshijnë rekomandimet e FATF-së. Kështu, organizatat që e kanë atë mbrohen nga rreziku i keqpërdorimit për pastrim parash dhe financim të terrorizmit. Organizatat qytetare për të marrë markën kryejnë një vetë-vlerësim, pas çka pason një rishikim i detajuar i dokumenteve dhe puna e Këshillit që e jep markën.

**Në vijim janë një sërë aktivitete për trajnim, për të kuptuar më mirë, masa në sektorin OJF me të gjithë sektorët (OJF, institucione, banka etj.). Kyçuni dhe bashkoni organizatave që dinë se si të mbrohen.**

## Përfitimet e Markës së mirëbesimit për organizatat qytetare përfshijnë:

- Njohje në bashkësi si partner i besueshëm që punon për interesin publik;
- Transparencë dhe llogaridhënie të rritur;
- Rritje të besimit tek donatorët lokalë ndaj organizatës;
- Dukshmëri të rritur tek donatorët potencial lokal;
- Vlerësim personal dhe zhvillim në punë.



## Ku mund të merrni informacione të rregullta?

Anëtarësohuni në Rrjetin për qëndrueshmëri financiare të organizatave qytetare dhe rregullisht merrni informacione, njoftime të rëndësishme dhe thirrje për përfshirje në aktivitete. Për më shumë informacione na kontaktoni në e-mailin tonë [konekt@konekt.org.mk](mailto:konekt@konekt.org.mk) ose në [02 3 22 41 98](tel:023224198).



"Plani vjetor i punës i Konekt është i mbështetur nga Civica Mobilitas"

